



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEÇ

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**“Supervizion punimesh per objektin :Ndertim i Impiantit te ujrave te perdorura (ITUN)
Bashkia Prrenjas ”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71247000- Mbikëqyrja e punës së ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

**4,208,243.45(kater milion e dyqind e tete mije e dyqind e dyzet e tre pike dyzet e pese) lekë
pa TVSH**

Fondi limit eshte perlllogaritur mbi bazen e Vendimin Nr.354 date 11.05.2016, te Keshillit te Ministrave, “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencise se Prokurimit Publik (APP) NR.5585Prot date 25.07.2017 “Mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin nr.354, date 11.05.2016 te Keshillit te Ministrave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEÇ SH.A**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, mbështetur në projektin dhe preventivin e miratuar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera 1 683 297.38(një milion e gjashtëqind e tetëdhjet e tre mijë e dyqind e nentëdhjet e shtatë pik tridhjet e tete) (40%) e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – e thjeshtuar Shërbime - prokurim me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vleres se së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,;

Gjithashtu, është përcaktuar jo më e vogël se 40% te vleres se së përlogaritur kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe

ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”. Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :b) **gjendjen ekonomike dhe financiare ;...** 3)Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet

ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhiro vjetore minimale të caktuar**. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:... të jetë jo më e vogël se vlera 1 039 380.46(një milion e tridhjet e nente mijë e treqind e tetëdhjet pik dyzet e gjashtë) (40%) e fondit limit të kontratës që prokurohet;

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare si me poshtë :Kopje te certifikuara te bilanceve te tre viteve te fundit 2023,2024,2025 te konfirmuara me vule prane administrates tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancinkontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat ” ,i ndryshuar pika 3.12etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon nëdatën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit , miratohen nga ministri përgjegjës për financat”.

Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe

të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojme xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2023,2024,2025) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmblidhjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 1 683 297.38**(një milion e gjashtëqind e tetëdhjet e tre mijë e dyqind e nentëdhjet e shtatë pik tridhjet e tete) **(40 % të vlerës)** së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmblidhjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda vlerës limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme, mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontratat të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”*, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me **Për punimet e përgjithshme në ndërtim** :

- **NP-1** Punime germimi ne toke
- **NP-2** Ndërtime civile dhe industriale
- **NP-4** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **NP-7 a** Ujesjellesa, Gazsjellesa, Vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje
- **NP-11** Ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linjat e TN dhe te mesem dhe shperndarjen e energjise
- **NP-12** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS – 4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS – 12** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit
- **NS – 13** Impiante dhe linja telefoni dhe telekomunikacioni
- **NS – 14** Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- **NS – 21** Impiante te trajtimit te ujerave te zeza

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknike në licencën e shoqërisë si më poshtë :

- **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Argumentimi:

2.3.2. Kërkesa për licencat profesionale

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë licencat profesionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit është vendosur në funksion të garantimit të një mbikëqyrjeje profesionale, të ligjshme dhe efektive të punimeve objekt kontrate. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, mbikëqyrësi duhet të ketë kapacitet profesional për të kontrolluar zbatimin e të gjitha disiplinave të projektit, sipas legjislacionit në fuqi.

Licencat **NP-1, NP-2, NP-4, NP-7 a, NP-11 dhe NP-12**, si dhe licencat për punimet speciale **NS-4, NS-12, NS-13, NS-14 dhe NS-21**, janë kërkuar pasi përfaqësojnë kategoritë kryesore të punimeve që përfshihen në projekt dhe të cilat do të jenë objekt kontrolli gjatë zbatimit të kontratës. Mbikëqyrësi duhet të ketë aftësinë profesionale të verifikojë cilësinë, përputhshmërinë me projektin, standardet teknike dhe zbatimin korrekt të punimeve për secilën prej këtyre kategorive.

Vendosja e kësaj kërkesë është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë kualifikime profesionale dhe teknike që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke respektuar parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Gjithashtu, kërkesa mbështetet në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, e ndryshuar, për licencimin profesional në fushën e ndërtimit.

2.3.3. Kërkesa për personelin kryesor teknik

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij **Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Elektrik, Inxhinier Mjedis, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Hidroteknik dhe Inxhinier Topograf/Gjeodet** është vendosur për të garantuar mbikëqyrjen e plotë teknike të të gjitha komponentëve të projektit.

Objekti i kontratës përfshin punime të natyrës civile, hidraulike, mekanike, elektrike, mjedisore dhe topografike. Për këtë arsye, secili profil inxhinierik është i domosdoshëm për kontrollin dhe certifikimin e punimeve sipas fushës përkatëse të ekspertizës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** mbikëqyr punimet civile dhe strukturore.
- **Inxhinieri Hidroteknik** kontrollon zbatimin e rrjeteve dhe veprave hidraulike.
- **Inxhinieri Elektrik** mbikëqyr instalimet elektrike dhe pajisjet elektromekanike.
- **Inxhinieri Mekanik** kontrollon montimin dhe funksionimin e pajisjeve mekanike.
- **Inxhinieri i Mjedisit** verifikon respektimin e kushteve dhe standardeve mjedisore gjatë zbatimit të punimeve.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet** garanton saktësinë e matjeve, kuotave dhe rakordimin e punimeve me projektin.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe synon të sigurojë që shërbimi i mbikëqyrjes të realizohet nga një staf me kompetencat e nevojshme profesionale. Ajo është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 dhe me VKM nr. 285/2021, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi kërkon vetëm profilet inxhinierike të domosdoshme për realizimin korrekt të objektit të prokurimit.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikëqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme si me poshte:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2026)** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- e) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet te jene ne perputhje me punimet e marra persiper.

Argumentimi: a) **ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë**

Kërkesa për certifikatën ISO 9001:2015 është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik disponon një sistem të standardizuar të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron planifikimin, organizimin, kontrollin dhe monitorimin e procesit të mbikëqyrjes së punimeve. Duke qenë se mbikëqyrësi është përgjegjës për kontrollin e cilësisë së zbatimit të punimeve dhe verifikimin e

përputhshmërisë së tyre me projektin dhe specifikimet teknike, kjo certifikatë garanton se shërbimi do të ofrohet sipas procedurave të dokumentuara dhe standardeve të njohura ndërkombëtarisht.

b) ISO 14001:2015 (ISO 14001-2026) – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

Kjo certifikatë është kërkuar për të garantuar se operatori ekonomik zbaton procedura të menaxhimit mjedisor gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij. Në kontratat e mbikëqyrjes, veçanërisht në projektet e infrastrukturës dhe ujësjellës-kanalizimeve, mbikëqyrësi ka detyrimin të monitorojë respektimin e kërkesave mjedisore të parashikuara në projekt, lejet dhe legjislacionin përkatës. Prandaj, disponimi i një sistemi të certifikuar të menaxhimit mjedisor lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

c) ISO 45001:2018(45001 – 2023) – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik ka procedura të konsoliduara për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Gjatë mbikëqyrjes së punimeve, stafi mbikëqyrës operon në kantier ndërtimi, ku ekspozohet ndaj rreziqeve të ndryshme. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori të disponojë një sistem të certifikuar për identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve, duke garantuar zhvillimin e sigurt të aktivitetit.

d) ISO 50001:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Energjisë

Kërkesa për ISO 50001 është vendosur duke marrë në konsideratë se objekti i mbikëqyrjes përfshin elementë dhe pajisje me konsum energjie, si stacione pompimi, instalime elektrike ose sisteme elektromekanike. Kjo certifikatë dëshmon se operatori ekonomik zbaton praktika të menaxhimit eficient të energjisë dhe ka njohuritë organizative për të monitoruar respektimin e kërkesave të eficiencës energjetike gjatë zbatimit të projektit, duke kontribuar në realizimin e investimit sipas standardeve bashkëkohore.

e) ISO 3834-2:2021 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim

Kjo certifikatë është kërkuar pasi objekti i kontratës përfshin punime ku realizohen ose kontrollohen lidhje të salduara, si tubacione metalike, konstruksione apo elementë mekanikë. Mbikëqyrësi duhet të jetë në gjendje të verifikojë që proceset e saldimit kryhen sipas standardeve teknike dhe kërkesave të projektit. ISO 3834-2 garanton se operatori ekonomik disponon procedura dhe kompetenca për kontrollin e cilësisë së proceseve të saldimit, duke minimizuar rrezikun e defekteve që mund të ndikojnë në sigurinë dhe jetëgjatësinë e veprës.

Keto kërkesa janë në përputhje me **nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020**, i cili lejon autoritetin kontraktor të kërkojë standarde të sigurimit të cilësisë dhe standarde të menaxhimit mjedisor, për sa kohë ato janë **të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës**, si edhe me **VKM nr. 285/2021** për rregullat e prokurimit publik.

Ne pergatitjen e ofertes, ofertuesit duhet te respektojne Vendimin Nr.354 date 11.05.2016, te Keshillit te Ministrave, “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencise se Prokurimit Publik (APP) NR.5585Prot date 25.07.2017 “Mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin nr.354, date 11.05.2016 te Keshillit te Ministrave, me qellim respektimin nga

operatorët ekonomikë të normave minimale të lejuara, të specifikuara në këtë vendim. **Orientim per ofertuesit:** VEPRÄ INXHINIERIKE sipas tipologjisë, si dhe në fondin limit të zbatimit të punimeve në tabelë përcaktojmë tarifën për të gjitha fazat e punimeve të përcaktuara në nenin 34 pika të VKM 354, datë 11.05.2016 konkretisht për fondin limit të zbatimit të punimeve **406,986,794** , lekë pa tvsh si dhe për *Grupin tarifor III* nga tabela me interpolim linear (REFERUAR SHTOJCËS NR.1 TË VKM 345 datë 11.05.2016 INTERPOLIMI) marrim vlerat maksimale dhe minimale që do të na shërbejnë për përcaktimin e fondit limit të Mbikqyrjes së punimeve

Komisioni